

## **AKT THEMELIMI**

### **I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "LUMINA ENERGY" SH.P.K.**

Mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në legjislacionin tregtar në Republikën e Shqipërisë, në ligjin 7512 datë 10.08.1991 "Për sanksionimin e veprimtarisë private", ligjin 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ligjit datë 2007 "Për QKR", dhe formalitetet që duhet respektuar, shoqëria tregtare plotësisht me vullnetin e lirë e të plotë për të nënshkruar këtë akt themelimi.

#### **Neni 1:**

#### **FORMULIMI**

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "LUMINA ENERGY" shpk do të nënshtrohet legjislacionit Shqiptar dhe degët që mund të krijohen do të nënshtrohen legjislacionit ku do të ketë selinë dega e Shoqërisë. Veprimtaria do të zhvillohet në bazë të këtij akti themelimi dhe statutit të shoqërisë.

#### **Neni 2:**

#### **Data e Themelimit, Emri dhe Identiteti i Themeluesit**

Sot, me datë 21 Maj 2024, Vjola Kurti, Atësia Xhevdet, datëlindja 03.07.1995, lindur në Burrel dhe banuese në Burrel, Rruga "Kuvendi i Burrelit", Lagja Drita, Godina Nr. 16, me numër letërnjoftimi 033122004 dhe nr personal J55703082R, e rritur dhe me zotësi të plotë juridike dhe zotësi të plotë për të vepruar, me shtetësi Shqiptare, në ora 13:00 vendosa themelimin e Shoqërisë "LUMINA ENERGY" SH.P.K. Themeluesi i Shoqërisë është Vjola Kurti, i cili është edhe ortak i vetëm dhe administrator i Shoqërisë.

#### **Neni 3:**

#### **Objekti**

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

" Shoqëria do të angazhohet në ndërmjetësim, operim, financim, projektim dhe menaxhim të prodhimit të energjisë përmes fotovoltaikeve, në përputhje me legjislacionin aktual Shqiptar. Kompania gjithashtu është e hapur për të eksploruar dhe angazhuar në metoda të tjera të prodhimit të energjisë. Për më tepër, shoqëria mund të ndërmarrë çdo aktivitet shtesë ose ndihmës që rezulton i dobishëm ose i nevojshëm për arritjen e qëllimit të saj kryesor.

Në përputhje me qëllimet e saj, Shoqëria do të jetë e gatshme të bashkëpunojë në mënyra të ndryshme, të drejtpërdrejta ose të tërthorta, dhe të marrë pjesë në Shoqëri të tjera me objekt të ngjashëm ose që kanë lidhje me objektivin e saj, ose që ndihmojnë në realizimin e këtij objekti.

Shoqëria mund të blejë, të shesë, ndërtojë, të japë e marrë me kredi apo të përdorë me çdo mënyrë të ligjshme të gjitha llojet e pronave të luajtshme e të paluajtshme, të vendosë pengje, hipoteka apo çdo barrë tjetër në pronat e veta të luajtshme e të paluajtshme si garanci të

detyrimeve të veta apo edhe të tretëve. Të marrë polica sigurimi për të mbuluar asetet dhe operacionet e veta. Të marrë të gjitha llojet e kredive afat shkurtër, afat mesëm apo afat gjatë nga ente vendase apo të huaja me apo pa titull financiar.

Shoqëria mund të kryejë import-eksport, tregtim, ndërmjetësim dhe ekspozimin e të gjithë materialeve fotovoltaike, materialeve ndihmëse dhe gjithashtu çdo lloj materialeve ndërtimore dhe teknologji të lejuara nga dispozitat e Legjislacionit aktual Shqiptar.

Shoqëria mund të merret me import, eksport, tregti me shumicë dhe pakicë brenda vendit materialeve dhe produkteve, ushqimore, industriale, kimikate si dhe produktet të tjera.

Projektim, studime fizibiliteti dhe ndërtim të tuneleve, puseve, minierave, objekteve industriale dhe jo-industriale. Kërkim, zbulim dhe shfrytëzim i dhe përpunim i minierave të çmuar dhe tregtimi i tyre brenda dhe jashtë vendit. Import, eksport, tregtim me shumicë e pakicë të mallrave të ndryshme industriale, materiale të ndërtimit, produkteve bujqësore, blegtorale, ushqimore etj. Import dhe tregtim me shumicë e pakicë të automjeteve dhe mjeteve minerale, ndërtimore të llojeve dhe tonazheve të ndryshme dhe pjesëve të këmbimit për to. Ndërtim, riparim të baseneve me kapacitete të vogla, të mesme dhe të mëdha. Gjithashtu Shoqëria mund të ndërtojë hidrocentrale të vogla, të mesme dhe të mëdha."

#### **Neni 4: Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat.

#### **Neni 5: Kapitali i Shoqërisë**

Kapitali i shoqërisë do të jetë 100,000 lekë (njëqind mijë lekë) me një kuotë, me 100% të kuotës të nënshkruar dhe paguar menjëherë.

#### **Neni 6: Selia**

Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga "Kuvendi i Burrelit", Lagja Drita, Godina Nr.16, Burrel, Shqipëri. Numri i celularit për kontakt është +355694878080 Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është [kurtivjola@gmail.com](mailto:kurtivjola@gmail.com).

#### **Asambleja e Ortakëve (ortaku i shoqërisë).**

#### **Neni 7: Organi Vendimmarrës**

Ortaku i vetëm është aktualisht organi i vetëm vendimmarrës.

#### **Neni 8: Administrimi**

Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të Shoqërisë. Afati i emërimit është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Emërohet administrator i shoqërisë dhe specimene të nënshkrimit:

Vjola KURTI,

Rruga "Kuvendi i Burrelit", Lagja Drita, Godina Nr. 16

#### **Neni 9:**

##### **Vula**

Shoqëria do të ketë vulën e saj dhe si të zakonshme shkrimet e thjeshta rreth saj.

#### **Neni 10:**

##### **Nënshkrimi**

Ky akt Themelimi është formuluar në katër kopje, pasi është firmosur me vullnetin e lirë dhe të plotë të themeluesit. Shoqëria deklarohet e krijuar.

### **ORTAKU I VETËM**

**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "LUMINA ENERGY" SH.P.K.**

**Vjola KURTI**